



**SHKPKK**

Shoqata Kombëtare e  
Pyjeve dhe Kullotave  
Komunale

www.shkpkk.org

# Kurora e Gjelbër



Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Tiranë (Viti i dymbëdhjetë i botimit) Nr. 87, janarr 2009 Çmimi 20 lekë

## 86 VJET SHËRBIM PYJOR SHQIPTAR

27 Janar 1923 - 2009



Pylltaria komunale është një rikthim në traditat më të mira të qeverisjes së pyjeve e kullotave nga vetë komunitetet rurale, për të frenuar degradimin e mëtejshëm të burimeve natyrore, për të rimëkëmbur pyjet dhe kullotat e degradura, për të ruajtur biodiversitetin e ndaluar shkretëtirëzimin e tokës dhe për të përmirësuar nivelin e jetesës të familjeve të përdoruesve e pronarëve të pyjeve e kullotave, nëpërmjet zbatimit të parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm e shumë-funksional të burimeve natyrore.



### TRANSFERIMI I PYJEVE KOMUNALE ...

Inxh. VLASH LEGISI  
DSHP Mirditë

Faqe 4, 5

### SHOQATA SHQIPTARE E SPECIALISTËVE TË PYJEVE, ANËTARE E UNIONIT EUROPIAN TË PYLLTARËVE



Prof. Dr. ARSEN PROKO

Faqe 5

### Shkëmbim eksperiencash

## MIDIS FEDERATAVE RAJONALE TË PYJEVE ELBASAN DHE KORÇË

Inxh. FATMIR BRAZHDA  
Sekretari i Federates Rajonale te Pyjeve e Kullotave Komunale Elbasan

Faqe 4

## NJË DITË, NË PYJET E DUMRESË

GJON FIERZA  
specialist në MMPAU, Tiranë

Faqe 2



“Ndërgjegjësimi i komunitetit për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota”

Faqe 3

### SHOQATA KOMBËTARE E PYJEVE DHE KULLOTAVE KOMUNALE

NATIONAL ASSOCIATION OF COMMUNAL FOREST AND PASTURES



www.shkpkk.org

GJON FIERZA

specialist në MMPAU, Tiranë

Në vendin tonë për më se 40 vjet, dhjetori është thirrur "Muaji i Pyjeve". Gjatë këtij muaji njerëzit e thjeshtë, pushtetarë, të gjithë dashamirësit e natyrës i kanë pasur pyjet më në vëmendje. Ndër veprimtaritë kryesore këtë muaj ka qenë dhe mbetet mbjellja e fidanëve pyjorë. Pyjet gjithnjë e më tepër po marrin rol të veçantë lidhur me vetë ekzistencën e jetës në tokë. Paksimi i ndikimeve negative të ngrohjes globale, të shtimit të gazit karbonik në atmosferë,



mund të ulen duke shtuar gjithnjë e më tepër mbulesën bimore të sipërfaqes tokësore, ku pyjet kanë rolin kryesor në këtë mbulësë. Nga komunitetit i pylltarëve dhe jo vetëm prej tyre, kërkohej harmonizimi i nevojave të njerëzve dhe të planetit për pyje, kështu bota mund të përparojë në rrugën e zhvillimit të qëndrueshem.

Për pyjet duhet menduar e punuar çdo ditë dhe kudo; kjo bëhet domosdoshmeri sidomos kur ato mungojnë, janë prerë apo djegur dhe bimësia është zhdukur, pra toka i nënshtrohet gërryerjes dhe degradimit të plotë. Aty duhet të bëhen ndërhyrje, me mbjellje të reja, të cilave duhet t'u praprihet me ndërgjegjësim të komunitetit vendor, si hap i parë për të patur sukses. Çdo vit në dhjetor janë mbjellë e vazhdojnë të mbillen mijëra fidanë pyjorë. Por, fatkeqësisht, pak prej tyre arrijnë të rriten e zhvillohen normalisht për të krijuar një grumbull pyjor. Për këtë mund të rendisim



shumë faktorë, por përcaktues është njeriu, me veprimin apo mosveprimin e tij. Për të arritur të krijimi i pyjeve të rinj, për t'i ruatur e zhvilluar ata ekzistues, së pari objekt duhet jenë njerëzit që e kanë jetën të lidhur me ta, pastaj zbatimi i teknikave pyjore. Të gjitha hapat e hedhura gjatë vitit 2008, ku në pronësi dhe përdorim të komunave e bashkive u kalua mbi 60% e fondit pyjor dhe 70% e fondit kullor,

# NJË DITË, NË PYJET E DUMRESË

synojnë përfshirjen e popullatave vendore në qeverisjen e qëndrueshme të kësaj pasurie.

Ishte ky prologu i bisedës gjatë një udhëtimit nëpër Dumre, ku na shoqëroi edhe botuesi Ali Lleshi, bir i kësaj zone, por me banim në Tiranë. Sapo e njoftuam se një grup specialistë pyjesh do të shkonim për të zhvilluar një takim për pyjet komunalë në Grekan, ai shprehu kënaqësinë për të marrë pjesë. Aliu la çdo punë dhe herët në mëngjes u vu në krye të vargut të makinave që udhëtonin për në Grekan. Nga Tirana në Dumre, nuk na lejoi të ndalonim as për kafe. Mëngjesin do ta hanim në Belsh. Me miqtë e tij, Aliu na gostiti mirë dhe shpejt, pasi nxitonim për të kapur orën e takimit.

Në vijim të bisedës, Aliu thote: Për pyjet veçanërisht jam shumë i ndjeshëm, dua të mos i mungojnë kësaj pllaje kaq të bukur, këtyre banorëve kaq punëtorë, Dumreja sigurisht ka të ardhme të mirë me turizmin ekologjik, padyshim pyjet janë të domosdoshëm e do t'i japin asaj vlera



akoma më të mëdha. Pasqyrat ujore të 80 liqeneve dhe kodrat e Dumresë në se arrijmë t'i qarkojmë me pyje, me toka të punuara, me ndërtesa të reja, do të kemi një nga pllajat unikale në Ballkan, me mjedise të papërsëritshme. Nuk di sa do të arrij, po nëse biznesi do me eci sadopak, sigurisht do kontribuoj në këtë drejtim. Malli dhe dashuria për vendlindjen janë në thellësi të shpirtit tim, shton ai. Gjatë rrugës Aliu u ndal disa herë, kur shihte fëmijë e u dhuronte libra e fletore, të përgatitura në shtypshkronjën e tij.

Kolona e makinave herë pas here ndalonte. Ata që vinin për herë të parë në Dumre donin të shijonin bukuritë natyrore, ku spikasin liqenet karakteristike të zonës, fshatrat e ndërtuar buzë tyre. Në ngjitje të kodrës prej ku do zbrisnim për në fshatin Dëshiran u ndalëm disi më gjatë, ishin disa njerëz që na prisnin e donin të na takonin. Njeri prej tyre ishte i njohur prej nesh që para disa vitesh. Eshtë Banush Kujja, me një sakicë në dorë na përshëndet dhe na fton në bisedë, aty në mes të një grumbulli pyjor të ripërtërirë këto vite. Banushi njihet për historitë e tij me pyjet; si një i burgosur para viteve '90 për dëme në pyje, por pas viteve 90 si njeri tepër i dashur e me kontribute të veçanta në ruajtjen dhe

mbjelljen e drurëve pyjorë. Ai ka mbjellë qindra fidanë pyjorë, duke krijuar një pyll me plepa e akacie prej rreth 40 ha, gati 100 ha të tjera me dushqe i ka përmirësuar. Banushi na foli me pasion për ripërtëritjen dhe zhvillimin e mirë të pyjeve në Dumre. Ai ishte i shqetësuar për disa probleme që kanë lindur me DSHP, për dhënien në përdorim, pastrimin

dhe mirëmbajtjen e pyjeve të komunës. Banushi u tregoi të pranishmëve si nisi dhe sa shpejt u bë ripërtrijja e këtyre pyjeve. Këtu në Grekan e Kajan, rreth 9 ose 10 vite më parë erdhi inxhinier Haki Kola me disa specialistë të tjerë. Na folën për pjesëmarrjen në një projekt dhe mbështetjen që do na jepej për t'i rimëkëmbur përsëri pyjet e Grekanit e të Kajanit. Kodrat këtu, lugina atje poshtë ishin të gjitha të zhveshura, ato u prenë nga viti 1992 dhe gjithçka mori fund me 1997. U

pikëlluam shumë si fshat - thotë Banushi, pasi pyjet më shumë u prenë nga të huajt, që nga fshatrat e Kuçovës e të Lushnjës. Ne dhe as organet e pyjores nuk i ndaluan dot. Po në vitin 1997, diku atje te bregu i liqenit ku unë kisha stanin, mbolla disa fidanë plepi dhe bëra disa ricungime. Pas disa takimesh në komunë e në fshatara, filloi mbështetja e Projektit të Pyjeve. U planifikuan disa punime, por kryesorja për ne fshtarët u përcaktua ndalimi i kullotjes dhe rrethimi i zonës që do të ripërtërithej.

Biseda do vazhdonte gjatë. Banushi dhe bashkëfshatarët e tij donin të thoshin shumë për këto vite. Ndoshta me plot gojën mund të themi u bë një "mrekulli e gjelbër", në Grekan. Sot, vetë fshati është zot i pyllit, nuk lejon asnjë demtim apo prerje, çdo gjë kërkohet të bëhet sipas projekteve të studjuara. Nga biseda me Banushin tejkaluam ndjeshëm orarin e takimit, ndoshta këtu u thanë natyrshëm disa nga ato që ishin prashkuar në programin e takimit, mirë u bë.

Vazhduam udhëtimin për në Dëshiran, ku na pritën kryetari i komunës, specialistë të pyjeve të Elbasanit, Gramshit, Librazhdit, banorë vendas, etj.

Natyrë ka ofruar kushte ekologjike, banorët vendas ofruan punën e përkujdesjen, me finacime modeste të Projektit shqiptar të pyjeve, jemi sot në brendësi të një masivi prej rreth 800 ha dushkajsh, që janë në gjendje mjaft të mirë, tha shkurt kryetari i komunës Grekan, Qemal Rama. Ai vazhdoi: Ju si specialistë i shihni, i vlerësoni vetë, ne kemi nevojë për ju, të na përcaktoni ndërhyrjet e nevojshme për këto pyje. Duam që pyllin ta kemi të përjetshëm dhe të marrim lëndë druri pa i



sjellë dëmtime atij. Ne duam të vijmë të pushojnë në këto hije, jo vetëm ne vendasit, por edhe miqtë që duan të vizitojnë Grekanin e Dumrenë.

Tashmë që këto pyje u ripërtërinë, kodrat u veshën dhe dushkajat po zhvillohen fuqishëm, lindi si domosdoshmëri trajtimi dhe orientimi i tyre për të ardhmen. Sigurisht që sivikultoret duhet të thonë falen e tyre. Pikërisht për të vlerësuar në terren disa trajtime eksperimentale të kryera në disa sipërfaqe prove, ishte dhe takimi në dushkajat e Grekanit në kuadrin e një projekti të SNV dhe SIDA-as. Në kater sipërfaqe prove, sipas një metodike të përgatitur nga inxhinierët Haki Kola e Janaq Male, janë zbatuar katër tipe rrallimi. Rezultatet e arritura u prezantuan nga inxh. Isuf Salla, realizues dhe ndjekës i punimeve. Diskutimet në terren vazhduan gjatë; argumente dhe vlerësime të ndryshme për çdo variant u dhanë nga mjaft specialistë të pranishëm, disa me përvojë të gjatë në pyje, dikush pedagog në Fakultetin e Shkencave Pyjore, dikush si pylltar komunal, etj. Në përfundim, mbështetur në rezultatet e dukshme në argumente shkencore, duhej të zgjidhej skema më e mirë e ndërhyrjes.

Nga të pranishmit u vlerësua maksimalisht ky takim larg akademizmave e prezantimeve stereotipe në salla luksoze. Aty ku pylli po rritej e zhvillohej, po parashkruhej dhe e ardhmja e një pylli për t'u mbarështuar sa më mirë në plotësim të



kërkesave mjedisore e turistike, në plotesim të nevojave për lëndë druri. Tërë keto diskutime, në një peizazh kaq të këndshëm, nxitonte për t'i filmuar gazetari i aposionuar i bujqësisë shqiptare Faut Memeli. Nuk do e kisha besuar thotë Fuati se kaq shpejt e kaq bukur mund të ripërtërihej një pyll si ky në Grekan. Këtë

Nisur nga problematika e shfaqur në menaxhimin e zjarreve të rëna, ku ndër kryesoret përmendim përdorimin efektiv të burimeve njerëzore e materiale, kapacitetet e pamjftueshme logjistike, neglizhencën dhe mungesën e përgjegjësive në realizimin e detyrave dhe në veçanti në punën e pamjftueshme për ndërgjegjësimin e komunitetit, më 15 dhjetor 2008, në qytetin e Vlorës, MMPAU dhe ECAT (Environmental Center for Administration & Technology) organizoi një workshop. Morën pjesë disa kryetarë të komunave të rrethit, përfaqësues të Bashkisë së Vlorës, të Prefekturës e të Qarkut, punonjës të Shërbimit Pyjor, etj.

Workshpi u organizua me qëllim diskutimin e situatës së krijuar nga zjarret në pyje e kullota, si dhe për të evidentuar masat që duhen marrë në të ardhmen.

Specialistë të ECAT, të MMPAU, dhe ekspertë të jashtëm, trajtuan disa tema mbi zjarret e shfaqura në pyje e kullota, problematikën, nevojën për ndërgjegjësimin e komunitetit në parandalimin e zjarreve, si dhe përdorimin e teknikave (Remote Sensing) për monitorimin e zjarreve në pyje.

Vitet e fundit e veçanërisht viti 2007, u karakterizuan nga kushte të pazakonta klimatike, me temperatura të larta e thatsirë të tejzgjatur, prandaj edhe pati një numri të madh zjarresh në pyje e kullota. Këto kushte klimatike, si dhe veprimtaria e pakujdesshme njerëzore ishin faktorët kryesorë të dëmtimit të ekosistemeve pyjore, me pasoja tepër të rënda për pyjet dhe mjedisin në përgjithësi.



Veçanërisht e rënduar ishte situata dy vitet e fundit edhe në qarkun e Vlorës, që pati numrin dhe sipërfaqen më të madhe të djegur nga zjarri, në krahasim me qarqet e tjera të Jugut. Si rezultat i rritjes së shpejtë të zjarreve situatat ishin të vështira për strukturat përgjegjëse për luftën ndaj zjarreve në pyje, duke rrezikuar edhe Parkun Kombëtar të Llogarasë.

Nisur nga gjendja e krijuar, për përbalimin e situatës, vitin e shkuar Këshilli i Ministrave, me vendim të veçantë, shpalli gjendjen e emergjencës, për shkak të zjarreve masive të shfaqura në pyje. Për këtë qëllim u ngrit Komiteti ndërministror i emergjencës, i cili planifikoi dhe vuri detyra

#### Vijon nga fq. 2

pyll, njerëzit që kanë kontribuar, ata që sot e ruajnë, duhet të jenë objekt i mediave vizive dhe të shkruara. Fuati, duke e venë theksin tek mediatizimi jo i plotë i këtyre shembujve, shton: Kam dëgjuar se dhe në disa zona të tjera në Elbasan, si dhe në rrethet Has, Mat, etj., ka pyje të ripërtëritë dhe fshtarët tregojnë për to një kujdes të jashtëzakonshëm, duke ndaluar çdo dëmtim.

Duhet kërkuar e gjetur mundësi për t'i përgjithësuar këto modele dhe njerëzit që qëndrojnë pas tyre, pyjet nuk duhet

# Mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga zjarret një ndër detyrat kryesore për Shërbimin Pyjor e Pushtetin Vendor

HALIM LALA  
Specialist në MMPAU, Tiranë



konkrete për secilën strukturë. MMPAU, duke vlerësuar në maksimum situatën e krijuar, u angazhua me të gjitha strukturat e saj në marrjen e masave të menjëhershme për përbalimin e emergjencës dhe koordinimin sa më të mirë të punës së Shërbimit Pyjor me institucionet e tjera shtetërore. Meqë ky Shërbim kishte kapacitete të kufizuara në forca pune, mjete e pajisje, u kërkuar ndihmë dhe mbështetje nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të

ekzistuese, vlerësuan përpjekjet e bëra nga drejtuesit e komunave Novoselë e Vranisht dhe kërkuar të njëjtin angazhim e preokupacion edhe nga bashkitë e komunat e tjera.

Në diskutimet e kryetarëve të komunave Novoselë e Vranisht, të përfaqësuesve të Bashkisë së Vlorës dhe institucioneve të tjera, krahas vlerësimit të prezantimeve të ECAT dhe angazhimeve për ndërgjegjësimin e komunitetit, kërkuar koordinimin e veprimeve në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve mes komunave fqinje dhe me policinë pyjore, pajisjen e tyre me doku-

mentacionin e nevojshëm ligjor, mbështetje me asistencë teknike, etj.

Përfaqësuesit e MMPAU, krahas vlerësimit për punën e bërë nga drejtuesit e Pushtetit Vendor të rrethit të Vlorës, sqaruan se MMPAU është institucioni që do të hartojë e propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të pasurisë pyjore e kullotave dhe në veçanti për mbrojtjen nga zjarri, pavarësisht nga forma e pronësisë mbi pyjet dhe kullotat. Kjo Ministri ka caktuar disa drejtime prioritare ku me transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Qeverisjes Vendore, krahas bashkëvendimmarrjes, do të kërkojë zbatimin e legjislacionit. Po ashtu, nga përfaqësuesit e MMPAU u nënvizua që me fillimin e vitit 2009, komunat dhe bashkitë duhet të fillojnë nga përgatitja e programeve të punës për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, ngritjen dhe funksionimin e shtabit të mbrojtjes nga zjarri në pyje, ngritjen e sistemit të lajmërimit, vrojtim sinjalizimit dhe skuadrave zjarrfikëse, përcaktimin e zonave me rrezikshmëri zjarri, nevojën e caktimit të një ose dy vrojtues zjarresh për periudhën qershor – tetor, etj.



## “Ndërgjegjësimi i komunitetit për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota” - Financuar nga Banka Botërore -

ECAT Tirana (Qendra për Administrimin dhe Teknologjinë e Mjedisit), në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të rrethit të Vlorës, Sarandë e Delvinë, po zbaton projektin “Fushatë ndërgjegjësimi për situatën e zjarreve në pyje dhe kullota”, financuar nga Banka Botërore. Ky projekt është komplementar i projektit “Inventari i zjarreve në pyje dhe ndikimi i tyre në pyjet komunale në Shqipëri”, financuar nga SNV (Organizata Holandeze për Zhvillim).

Qëllimi i këtij projekti është të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet e menaxhimit të zjarreve, si dhe të zgjerojë bazën e të dhënave për zjarret në pyje e kullota gjatë vitit 2007, të krijuar nga projekti i mëparshëm, me qëllim që rekomandimet dhe konkluzionet e nxjerra nga këto të dhëna të jenë të zbatueshme për të gjithë territorin e Shqipërisë.

të mbeten objekt i mediave vetëm në dhjetor. Nuk duhet të përbëjnë lajm vetëm mbjelljet e disa qindra fidanëve akacie apo pishe, pasi një rast si ky i Grekanit me dushkaja, janë vlera të larta të arritura duke përdorur fonde modeste.

Bisedat, diskutimet dhe vlerësimet e eksperimenteve të zbatuara në Grekan, në tërësi për pyjet e Dumresë, dalngadalë i ndërpreu muzgu, i cili po mbulonte pllajen e Dumresë.

Kjo ditë e kënaqshme në pyjet e rilindura të Dumresë, nuk mund të mbyllet

pa provuar dhe mikpritjen, gatimin tradicional pse jo dhe këngën e Dumresë, kjo u realizua në një nga lokalet e shumta moderne në qendër të komunës.

Le të kontribuojmë për sa më shumë pyje dhe zona të tjera. Dumreja e bekuar nga zoti le të behet akoma më e bukur e më e begatë me pyjet e saj.



## Shkëmbim eksperiencash

# MIDIS FEDERATAVE RAJONALE TË PYJEVE ELBASAN DHE KORÇË

**N**ga një koordinim i përbashkët i Federatave Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave Komunale Korçë dhe Elbasan, mbështetur nga Organizata Holandeze për Zhvillim SNV, u mundësua një vizite për shkëmbim eksperiencash nga tri shoqata të Federatës së Elbasanit (përkatesisht komunat Qender, Stebleve-Librashd dhe Gjinar-Elbasan në Komunën Liqenas, Korçë.

Një grup prej 20 vetash udhëtuan drejt Korçës të organizuar mirë dhe të shoqëruar nga Sekretari i Federatës Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave Komunale Elbasan, Inxh. Fatmir Brazhda, si dhe anëtarë të stafit teknik të Federatës, inxh. Isuf Salla. Grupi i përbërë nga kryetari i komunës Stebleve, Xhevit

Boriçi, kryetare shoqatash të Gjinarit, Qendrës e Steblevës, si dhe anëtarë të tyre, patën si desitacion Komunën Liqenas dhe pikerisht Shoqatën e pyjeve në këto komune.

Në Liqenas, afer Liqenit madheshtor të Prespes, kryetari i Shoqatës, Vasil Jankulla priste me stafin e tij koleget nga Elbasanit për të treguar punën e bërë dhe eksperiencën e fituar gjatë implementimit të projekteve të ndryshme. I palodhur, i qetë e i qeshur, ai me dashamirësi u takua me koleget dhe filloi me nxitim të jepet një listë objektesh të zbatuar sipas projekteve që kjo shoqatë kishte përfituar sipas donacioneve. Koleget nga Elbasani në një farë mënyre mbeten të habitur se si Shoqata e Liqenasit kishte

mundur të përfitojë kaq shumë projekte edhe nga organizata të tjera. Nga pyetjet që iu drejtuan atij se në ç' mënyrë janë përfituar këto projekte, ai tregonte se vetëm duke kërkuar investime dhe duke patur projekte në duar, pasi pa projekte asnjë organizëm nuk të mbështet. Duke hartuar projekte e duke trokitur në zyrat e shume donatoreve, mundem të marrim investime nga MADA, PZHBN, REC, etj., thekson Vasili.

Pas vizitave në objektet e përfituara (permiresime pyjesh, ndertim koritash dhe lerash) koleget e Vasilit u binden se ai kishte bërë një punë mjaft të mirë e dobiprurëse për pyjet komunale e kullotat, si dhe mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve, si pjesë integrale e Parkut Kombëtar të Prespes.

Nga pamja mahnitese e Liqenit të Prespes dhe projektet model të SHPPKK të komunës, vizitorët arritën të ndjeheshin me optimistë për të punuar edhe me shume në komunat e tyre.

Në takimin e organizuar së bashku në një ambient përbi Prespes, përfaqësuesit e shoqatave shkëmbyen mjaft njohuri, si dhe shfaqën mendime për funksionimin e shoqatave. Me theks të veçantë u shtrua nevoja për permiresimin e legjislacionit mbi pyjet komunale, konkretisht mbi të drejtat e përdorimit, pronësive, kufijve të qartë të pyjet e shtetit, heqjen e detyrimeve fiskale për SHPPKK, mbështetjen nga shteti me forma organizimi dhe investime, caktimin e specialisteve në organiken e komunave, etj.

Pjesëtarët e grupit nga qarku i Elbasanit u larguan nga Liqenas i Korçës jo vetëm me entuziastë me ato që panë e mësuuan, por edhe me mbresa të pashlyeshme për mikpritjen. Prandaj edhe i ftuan koleget nga Liqenas të vizitojnë komunat e tyre.

Korresp. i "Kurorës ..."

## Jo vetëm për kureshtje

Agr. VALENTIN GOCAJ

## E pabesueshme, por e vërtetë

Sapo kalon Urën e Bunës në drejtim të zonës Ana e Malit, syri të pushon në masivet me afro 90 000 rrenjë ullinj të të gjitha varieteteve, që shtrihen në kodrat e kësaj zone. Në çdo familje, majtas e djathtas rrugës, do të shohësh të shpalosur traditën anamalëse të kultivimit të perimeve, në fushë dhe në serra e tunele. Traditë kjo e trashëguar deri në ditët e sotme, duke krijuar edhe lloje autoktone, tashmë të njohur në të gjithë vendin. Krahas perimeve, shikon të harmonizuar mirë shumëllojshmërinë e pemëve, që nga ato tradicionale deri tek agrumet. Aty do të gjesh që nga shega, me shumicë, fiku i

famshëm i Krebajve ("Tivaras") e deri tek pemët e rralla, si kimça e të tjera. Të gjitha këto janë një kombinim i shkëlqyer i kushteve ekologjike e agropedologjike të kësaj zone të mbrojtur nga Veriu nga mali i Taraboshit, të ngrohur nga deti dhe të freskuar e ujitur nga Buna, me nnamalasisit, siç i cilësonte Padër Anton Harapi "Njerëz të urtë e shumë punëtorë.

Të gjitha këto i quajmë krejt normale për një zonë me traditë bujqësore si Ana e Malit. Por habia dhe e pabesueshmja ndodhi një ditë kur me një grup pune bënim studimin e pyjeve komunalë të zonës. Në fshatin Shtuf të kësaj komune,



në lagjen Velaj, në një luginë të vogël, mes dy kodrave të mbuluara me pyje dushku, dallon një pemë e stërmadhe, afro 100 vjeçare, me diametër 60 cm. Kjo është një dardhë, që vazhdon të japë prodhim.

Shoqëruesi, një vendas, nga Shtufi, na tregon se kjo dardhë ishte e shartuar mbi Lis.

Pasionanti Sait Vela, i cili tashmë nuk jeton, e përjetësoi pasionin e tij duke bërë të pazakonshmen, duke shartuar dardhën mbi lis (dhe kjo dallon qartë po ta shikosh). Janë të njohur shumë lloje shartimesh, por ky, midis dy gjinive krejt të largëta e të ndryshme, është diçka pothuaj e pabesueshme. Por kjo dardhë shekullore është dëshmi e gjallë e këtij fakti. Përputhja është e habitshme sepse si nënshartesa (lisi) edhe mbishartesa (dardhë vendi, Verdrukla) kanë të njëjtin zhvillim, të njëjtën trashësi, por që dallohet qartë pika e shartimit. Ai, me këmbëngulje, duke bërë shumë e shumë lloje shartimi, arriti të bënte të pabesueshmen, që vetëm kur e shikon me sy bindesh për këtë mrekulli popullore.

# TRANSFERIMI I PYJEVE KOMUNALE KA MBETUR TEK NËNSHKRIMI I PROCESVERBALEVE TË DORËZIMIT

Inxh. VLASH LEGISI - DSHP Mirditë

**P**eriodha tetor 2007 – qershor 2008 mund të konsiderohet mjaft e ngarkuar dhe intensive për finalizimin e dokumenteve të transferimit të pyjeve komunale. Duhet theksuar se në këtë angazhim të madh peshën kryesore e ka patur personeli pyjor si njësi e kualifikuar që jo vetëm ka hartuar aktmarrëveshjet, listën e pronave, procesverbalet e dorëzimit, etj., por është marrë edhe me plotësimin e shkresave të njërive vendore. Është e kuptueshme që ndihmesa e personelit pyjor ishte e domosdoshme jo vetëm në fazën fillestare të hartimit e plotësimit të dokumenteve, por edhe më vonë për të gjitha problemet e procedurat e administrimit të pyjeve komunale nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, pra duhet të jetë e përhershme prania e rolit kshillimor të DSHP.

Rezultati i punës së vazhdueshme midis DSHP dhe Njërive Vendore u arrit që në fillim të qershorit 2008 në një takim të veçantë, ku ishin të pranishëm të gjithë kryetarët e Njërive Vendore dhe zv.



Prefekti. Mbas diskutimeve u arrit nënshkrimi i procesverbaleve të dorëzimit të fondit pyjor e kullor për çdo njësi vendore më vete. Në total në shtatë Njësi Vendore janë dorëzuar 38509 ha pyje e

kullota ose 60.5 % e fondit pyjor që ka rrethi i Mirditës, duke plotësuar kështu objektivin madhor të Qeverisë për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi e përdorim të Njërive të Qeverisjes Vendore.

Sipas këtyre shifrave të pasqyruara në procesverbalet e dorëzimit del se për çdo Njësi Vendore janë dhënë 5-6 mijë ha pyje.

Në zbatim të detyrës së dhënë nga Ministria e Mjedisit dhe e Pyjeve, DSHP ka dërguar në komuna disa vendime të KM për tarifën dhe kriteret e administrimit. Nga drejtuesit e Njërive Vendore ka patur kërkesa për transferimin e kontratave që ka DSHP me operatorët celularë në territorin e pyjeve komunale, si dhe aktivitete të tjera, që kryhen nga firma ose kompani private. Ndërkohë, ka patur edhe veprime të përbashkëta për rastet e zjarreve dhe prerjeve ilegale, pra përgjithësisht shqetësimi i komunave është i dukshëm për ruajtjen e pyjeve.

Në zbatim të VK Nr. 396, dt. 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore" pika 4, duhet filluar nga puna për regjistrimin e sipërfaqes pyjore në zyrën e regjistrimit të pasurive të

# SHOQATA SHQIPTARE E SPECIALISTËVE TË PYJEVE, ANËTARE E UNIONIT EUROPIAN TË PYLLTARËVE

doslaësky (University of Technology - Graz; Styria/Austria) me temë: Pylli dhe Energjia - mundësi të reja. Cilat janë problemet europiane? Cilat janë potencialet e biomasës së drurit? Në këtë prezantim mjaft interesant, theksohej se nga gjithë alternativat e energjisë së rinovueshme, në kushtet e një krize mbarëbotërore ushqimore, sfida e energjisë së rinovueshme mbeten pyjet.

Meqë mbledhja u zhvillua në prag të Javës së Parë Europiane të Pyjeve, doli me një deklaratë, ku theksohej: Java e Parë Europiane e Pyjeve mbahet në një kohë kur ne po ballafaqohemi me sfida të mëdha në shoqëri dhe sektorin pyjor.



Ndryshimet klimatike, të shoqëruara me dukuri katastrofike, si psh. rreziku i zjarreve, nevoja në rritje e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe mbrojtja e natyrës, janë shëmbuj të çështjeve më madhore me të cilat shoqëria dhe pylltaria po përballen sot.

Burimet pyjore në Europë kanë shumë mënyra për të mbështetur shoqërinë me mirëqenie dhe prodhime drunore. Burimet pyjore, megjithatë, duhet të

përdoren në mënyrë më eficiente, duke marrë në konsideratë njëherësh mbrojtjen e natyrës në përgjithësi. Shoqëria ka nevojë për më shumë prodhime dhe kënaqësi nga pyjet. Pavarësisht rritjes së prodhimeve e të mirëqënies nga pyjet ka më shumë nevojë për lëndë druri, industri dhe energji. Të gjitha përfitimet nga pylli duhet të mobilizohen në mënyrë të qëndrueshme dhe me eficiencën më të mirë të mundshme.

Ne duhet të rritim njohuritë tona në mundësinë dhe mbrtshmërinë e burimeve pyjore, të mirave të tij dhe sfidave të pranishme në mobilizimin e këtyre burimeve. Eksperienca jonë nga praktikat më të mira së bashku me inventaret e



Specialistët e pyjeve kanë rol qëndror në sektorin e bio-energjisë, duke çuar në nivel të lartë inovacionin, zhvillimin teknologjik dhe kërkimin.

Rrjeti i gjerë i profesionistëve në Unionin European të Pylltarëve po punon shumë fuqishëm për të mirën e sektorit pyjor në Europë. Në mënyrë që të zhvillohen burimet pyjore në të ardhmen, është i nevojshëm shtimi dhe aftësimi i burimeve njerëzore në pyje.

Sektorit pyjor i Europës është i rëndësishëm për mirëqenien e shoqërisë europiane dhe i aftë të mbështesë një të ardhme të mirë e të sigurtë. Bëni çdo javë një ditë të pyjeve në Europë.

Anëtarësimi i Shoqatës Shqiptare të Specialistëve të Pyjeve në Unionin European të Pylltarëve do ta bëjë atë më të përgjegjshme e më të pranishme në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit pyjor e kullësor në vend.

Duke u asociuar me Unionin European të Pylltarëve, mendojme se kemi kontribuar sado pak në përpjekjet për integrimin e atdheut tonë në Bashkimin European.

**Korresp. i "Kurorës ..."**



**M**e 16-19 tetor 2008, në Gmunden të Austrisë u zhvillua Mbledhja e Këshillit Drejtues të Unionit European të Pylltarëve, në bazë të statutit të kësaj organizate, lidhur me problemet e pylltarisë europiane, parë në fokusin e zhvillimeve globale e kontinentale. Në mbledhje merrnin pjesë presidentët e një sërë shoqatash e organizatash nga vende të ndryshme të Europës, si Danimarka, Finlanda, Suedia, Franca, Rumania, Çekia, Austria, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Gjermania, Irlanda, Lihtenshteini, Luksemburgu, Spanja, Portugalia, Zvicra, etj.

Shoqata Shqiptare e Specialistëve të Pyjeve, e përfaqësuar nga kryetari i saj, Prof. Dr. Arsen Proko, merrte pjesë për herë të parë, me qëllim anëtarësimin me të drejta të plota në të, pasi kishte depozituar kërkesën për anëtarësim rreth një vit më parë.

Një nga pikat e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje ishte edhe pranimi i anëtarëve të rinj, ku anëtarësimi i Shoqatës Shqiptare të Specialistëve të Pyjeve u miratua njëzëri mbas një prezantimi të delegacionit shqiptar mbi pyjet, pylltarinë dhe rolin e shoqatës në proceset e reformimit të sektorit pyjor e kullësor në Shqipëri. U theksua roli i saj aktiv e pozitiv në zhvillimet e reja të reformimit të sektorit tonë pyjor.

Axhenda përmbante raporte mbi aktivitetin e këtij Këshilli në periudhën ndërmjet dy mbledhjeve, si dhe një referim kryesor nga Prof. Dr. Michael Naro-

paluajtshme. Fakt është se deri tani nuk është kryer asnjë veprim nga shtatë njësi vendore që ka rrethi i Mirditës, të cilat nuk mund të njihen si pronarë të ligjshëm të pronave pyjore e kullësore pa kryer regjistrimin e tyre pranë institucionit përkatës. Ndërkohë edhe nga organet qëndrore nuk është nxjerrë ndonjë udhëzim i posaçëm me kritere dhe afate për të kryer regjistrimin e pronave pyjore e kullësore të marra në dorëzim, si hap i parë për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.

Po ashtu, problematike është edhe kërkesa për ngritjen e strukturave të specializuara pranë njësive vendore. Për këtë kemi kontaktuar me të gjithë kryetarët e njësive vendore, kanë ardhur edhe specialistë nga Ministria por gjendja mbetet e pandryshuar, pra në asnjë njësi vendore nuk janë ngritur këto struktura të domosdoshme për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve komunale. Kryetarët e njësive vendore janë të gatshëm për ngritjen e strukturave të kualifikuara, por shprehen se nuk po gjejnë njëzërit e përshtatshëm për ti besuar në të ardhmen ndjekjen e kësaj detyre.

Sipas mendimit tonë për të gjitha kërkesat e shprehura në VKM Nr. 396. dt. 21.06.2006 dhe Nr. 22 dt. 09.01.2008, duhet të kishte një aktmarrëveshje ose një udhëzim i përbashkët midis dy dikastereve përkatësisht të Ministrisë së Mjedisit dhe asaj të Brendshme si dy organe qëndrore të përgjegjshme qeveritare për dhënien dhe marrjen në dorëzim të pyjeve e kullotave komunale.

Hartimi i një udhëzimi të përbashkët me kritere dhe afate konkrete, organizimi i takimeve zonale me përfaqësues të njësive vendore dhe të drejtorive të Shërbimit Pyjor do të bënte të mundur regjistrimin e pronave pyjore dhe ngritjen e strukturave të kualifikuara në çdo njësi vendore për të marrë përgjegjësitë ligjore në administrimin e këtyre pronave, që do të thote evitimin e në periudhë 6 mujore pothuaj latente nga momenti I nënshkrimit të proces-verbaleve të marrjes në dorëzim e deri më sot.

Përsa i përket ngritjes së strukturave të specializuara në njësitë vendore mendojmë se në radhë të parë ajo duhet ngritur pranë Ministrisë së Brendshme,

kujdesshëm mbi pyjet do të ndihmojë në dyluftimin me këto sfida.

Nga ana profesionale, bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe në bashkëveprimin pyll - njeri, specialistët e pyjeve janë e do të jenë aktorët kyç.

Specialistët e pyjeve kanë rol qëndror në edukim dhe trainim, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të energjisë së sektorit dhe përdorimin shumëfunktional të pyjeve.

çka do të japë një mesazh konkret për vazhdimin e punës në njësitë vendore, do të vendosë kontakte me DSHP dhe struktura të tjera për të zgjidhur të gjitha problemet dhe pengesat e mundshme.

Pavarësisht këtyre zvarritjeve për zbatimin e procedurave të përcaktuara në VKM, personeli pyjor i DSHP Mirditë asnjëherë nuk e ka shkëputur vemendjen për administrimin dhe ruajtjen e pyjeve komunale, duke kryer kontrole për prerjet e paligjshme, cfacjen e vatrave të zjarrit, vrojtimit e sëmundjeve dhe dëmtuesve si dhe bashkëpunimin me kryetarët e fshatrave e të drejtuesve të njësive vendore. Të ndërgjegjshëm për misionin tonë edhe në të ardhmen do të vazhdojmë ta kryejmë detyrën tonë si në pyjet publike po ashtu edhe në ato komunale por në të njëjtën linjë jemi të interesuar që sa më shpejt të merren masat e duhura për funksionimin real të pronave pyjore komunale, duke kryer regjistrimin e tyre dhe ngritjen e strukturave të kualifikuara, ndërsa personeli i DSHP të ketë rolin këshillimor siç përcaktohet në VKM për dhënien e asistencës së nevojshme në

njësitë vendore dhe kontrolli i policisë pyjore për të siguruar zbatimin e legjislationit pyjor.

Tashmë jemi në mbyllje të vitit 2008 dhe njëkohësisht bëhen përgatitje për fillimin e vitit 2009. Kjo periudhë pune duhet të funksionojë edhe në njësitë vendore për zbatimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal të shprehura në VKM Nr. 22, dt. 09.01.2008. Konkretisht bëhet fjalë për pikat 7-15 që kanë të bëjnë me projektplanin e shfrytëzimeve, verifikimet e nevojshme nga DSHP, prodhimet e dyta, afatet e miratimit si dhe kryerjen e damkimeve për rastet konkrete. Të gjitha këto, si dhe procedura të tjera të përcaktuara në vendim, mund të ndicen dhe zbatohen vetën atëhere kur është ngritur struktura e specializuar pranë cdo njësie vendore.

Të gjitha problemet e përmendura në këtë material nuk kanë objektiv kritik por shqetësimin e ligjshëm për të arritur dorëzimin fizik të pyjeve komunale dhe për të patur ecuri normale të këtij objekti në njësitë e Qeverisjes Vendore.

# Një veprimtari e bukur e gazetarëve të bujqësisë

FUAT MEMELI, Kryetar i Shoqates se Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë

**- Këtë Shoqata do të festojë 15 vjetorin e krijimit të saj**  
**- Kongresi i Federatës Botërore të Gazetarëve të Bujqësisë (IFAJ) sivjet do të zhvillohet në Teksas të SHBA-së**



**P**rej disa vjetësh, është kthyer në traditë, takimi i anëtarëve të Shoqatës së Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë, në prag të Vitit të Ri. Kështu ndodhi edhe këtë Viti të Ri. Më 23 dhjetor, anëtarët e kësaj shoqate u mbledhën në Vilën 14, diku në zonën e ambasadave, për të festuar së bashku. Me këtë rast, në hyrje të lokalit ishte vendosur një fotoekspozitë e vogël, me pamje nga veprimtaritë e Shoqatës. Pas urimit për një vit të mbarë nga kryesia e Shoqatës, e kishte radhën rakia, vera e birra, të shoqëruara me mezet e gatuar bukur e me shije nga i zoti i lokalit. Urimet dhe përshëndetjet ia linin rradhën njëra - tjetrës. Një vlerësim të veçantë për Shoqatën tonë, bëri gazetari veteran, ish-drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Marash Hajati, i ftuar në këtë veprimtari. – Më bën përshtypje organizimi i bukur i veprimtarive nga Shoqata juaj, harmonia dhe fryma shoqërore që kini me njëri - tjetrin. Është vërtet për t'u patur zili – nënvizoi ai.

Folën shkurt e ngritën doli mjaft nga të pranishmit, ndërmjet të cilëve gazetarët me përvojë, Veli Hoxha, Ago Nezha, Pasho Baku, Xhevdet Bashllari, etj. (Këtij të fundit, në shtator Shoqata i organizoi një veprimtari, me rastin e 60-vjetorit të lindjes).

Një çast i veçantë i atij takimi, ishte leximi i përshëndetjeve të dërguara nga Amerika prej kolegëve tanë, Shefqet Meko (ish kryetari i parë e nismëtar i krijimit të

Shoqatës sonë), si dhe Fiqri Shahinllari. Të dy këta kolegë kanë qenë emra të njohur në gazetarinë bujqësore shqiptare dhe kanë lenë gjurmë në këtë fushë.

Vlerësimi me dëshmi për disa nga anëtarët, që me punën e tyre gjatë vitit të kaluar kishin lenë më shumë gjurmë në gazetarinë bujqësore, të pyjeve e mjedisit, si dhe për kontribut në organizimin e veprimtarive të Shoqatës, ishte një çast tjetër i veçantë i takimit. Për vitin që kaloi, kryesia e Shoqates kishte veçuar emrat e Haki Kolës, Enver Shehajt, Enver Isufit dhe Agim Rametës.

Kënget, vallet dhe humori, ishin pjesë e pandarë e takimit, që u mbyll me foton e gjithë pjesëmarrësve, ne oborin e lokalit.

Këtë vit Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë mbush 15 vjet. Le të shërbejë kjo ngjarje për të gjallëruar veprimtarinë e Shoqatës sonë, për të ngritur më shumë zërin për problemet e bujqësisë, pyjeve dhe mjedisit, për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të saj, si dhe për të organizuar më shumë veprimtari në këtë vit jubilar.

Ngjarje tjetër e shënuar gjatë këtij viti, do të jetë edhe kongresi i Federatës Botërore të Gazetarëve të Bujqësisë (IFAJ), që do të zhvillohet në Teksas të SHBA-së, në muajin gusht. Federata nuk merr përsipër shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit. Kush ka mundësi që të shkojë, kryesia do ta ndihmojë me përgatitjen e procedurës, për të marrë pjesë në kongres.



**Në Redaksinë e gazetës "Kurora e gjelbër" diskutohet për numrin e radhës**

Siç përmendet edhe në shkrimin e kryetarit të Shoqatës së Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë, Fuat Memeli, një takim i posaçëm i kësaj Shqate u organizua me rastin e 60 vjetorit të lindjes së kolegut tonë, gazetarit me përvojë, Dr. Xhevdet Bashllari. Në këtë takim, me një pjesëmarrje të gjerë, u fol e u sollën shumë aspekte të jetës e punës së frytshme të Dr. Bashllarit. Një përshëndetje të thjeshtë e jaft dashamirëse dërgonte edhe ministri i Bujqësisë, Jemin Gjani: "Urime. Është e rendësishme se ke ardhur në këtë cak, duke gëzuar shëndet të mirë dhe vullnet për punë të mëtejshme. Jetë të qetë e të mirë për vete, bashkëshorten dhe fëmijët".

Me këtë rast, redaksia e gazetës "Kurora e Gjelbër" po boton një pjesë të shkurtër të letrës përshëndetëse që dërgonte posaçërisht për këtë takim kolegu ynë Shefqet Meko, ish-kryetari i parë i Shoqatës sonë. Menduam se aty thuhet gjithçka do të sillej në një shkrim enkas për atë ditë të shënuar për Xhevdetin po edhe për ne kolegët e tij. Në këtë letër "vjen" njëherësh edhe malli i patreguar i mjaft kolegëve gazetarë, po edhe i shumë shqiptarëve të tjerë, që për arsye që dihen janë larguar nga vendi ynë e janë shpërndarë nëpër botë.

## Për njeriun e mirë Xhevdet Bashllari!



I dashur Xhevdet, miq, kolegë, ish-miq e ish-kolegë!

Ju jeni bashkë sot për të gëzuar ditën e shënuar që lindi Xhevdeti. Ju jeni atje, në Tiranën e endrave dhe nostalgjive tona për t'i uruar Xhevdet Bashllarit edhe 100 të tjera. E si mund t'u duket Xhoda ketu e njeqind vjet?! ... Sido që të imagjononi, ai sërish do të jetë thjesht njeri i mirë! Viktor Hygoi diku ka shkruar "Të dyzetat janë mplakje e rinisë, të pesëdhjetat janë rini e pleqërisë".

Por mos u tremb o Xhevdet nga vitet e moshës! Vitet janë e vetmja pronë private që as i shet e as i ble, as i jep borxh e as t'i kërkon kush, as i vjedh e as nuk t'i vjedhin. Ato janë vitet e tua, jeta jote. Dhe jo thjesht se është "dita e Xhevdetit" sot, por kjo është ditë që ju të gjithë duhet të gëzoheni sepse keni pranë një njeri që nuk e mplakin vitet, edhe pse mund t'i japin ndonjë thinjë apo rrudhë. Xhevdeti mbetet i ri në shpirt, në sjelle, në mirësi e përkushtim njerëzor. Ai është një prind i shkëlqyer e bashkëshort shembullor, që me thonj e burrëri ka ngritur familjen e vet nga e puthura e parë në Ujmisht të Kukësit e deri tek vila që po ndërton tullë pas tulle në Tiranë. Nuk dua t'i bëj portertin si specialist, sepse ju që jeni aty e dini më mirë se unë që kam një dekadë ikur, por dua t'u sjell vetëm pak nga "troba" plot me kujtime që kam me Xhevdetin.

Xhevdet Bashllari, bart për 6 dekada një karakter e burrëri që jo të gjithë ne mund t'i ngajmë. Ai thotë një fjalë dhe e bën. Ai bën një premtim dhe e mban. Ai te thote shok dhe të mbron. Ai të ngre dollinë dhe e pi me fund. Ai s'le kënd të të shajë pas ... Xhevdeti, di se çdo të thotë vlerë, njeri, sakrificë, respekt, di çdo të thotë të respektosh mikun dhe shokun ...

I dashur Xhevdet, fati jot i madh është që këtë ditë shënuar të jetës tënde e feston në Tiranë, ku flitet shqip e këndohet shqip dhe pihet birra Korçe apo Tirane ... Ne të ikurit i gëzojmë këto çaste të bukura vetëm

një herë në 2-3 vjet apo edhe më shumë. Por edhe është mirë që jemi larg, sepse kështu e kuptojmë më mirë vlerën e vendit tonë dhe mundësitë që të jep atheu ... Duke qenë larg edhe e duam më shumë njëri-tjetrin.

Unë do të desha të flisja shumë për Xhevdetin, por ju keni shumë më tepër ... Vetëm një gjë nuk e ka mirë Ai, "duhet të mësojë të pranojë edhe njëçikë qyl, se qyli është një rrugë që të çon në Perëndim" ... Këtë e them si me shaka, po nisem nga raste që më kanë ndodur, kur Xhevdeti s'pranonte as të hante një drekë nga dikush që e jepte për një nder të bërë apo një punë të kryerë. Tani që kujtoj këto momente pyes veten: Si do të ishte Tirana, apo edhe gjithë Shqipëria sikur të kishte më shumë njerëz të pakorruptueshëm, si Xhevdeti?

Unë them se karaktere të tillë janë të rrallë. Në 60 vitet e Bashllarit ne shohim ndershmëri, punë, miqësi dhe mbarësi ... Djali im 14 vjeçar, që vizitoi Tiranën verën e shkuar, jo më kot do të më thoshte: "Babi, rri edhe 100 vjet të tjerë në Amerikë, si këta shokë që paske në Tiranë nuk do të gjesh kurrë ... Në Amerikë, shumë leka, pak shokë ... Këtu shumë shokë". Djali e kishte fjalën edhe për Xhevdetin, edhe për ju shokë të mirë, që jeni mbledhur bashkë në këtë përvjetor të bukur të këtij njeriu pa thinja në shpirt. Ky është Xhevdet Bashllari. Gorari që nuk më bëri dot gorar, mua ikanakun nge Pretusha, që vazhdoj të iki e të vij tek ai vend ku ne bashkohemi e festojmë ditëlindje të bukura si kjo e stomja.

Të dashur miq e shokë, Xhevdeti duhet të priste 60 vjet për të ardhur tek ky cast, kur një ikanak e uron me mall nga Amerika dhe, po aq me mall e nerëzi ju uron të gjithëve: Paçi vetëm gëzime dhe ditëlindje!

**Shefqet Meko**  
**Minneapolis, SHBA**

# Efektiviteti ekonomik i importit të pllakave të zdrukthit, fibrës e MDF-së

Msc. Ing. DORIZ MARJANI

**E**fektiviteti ekonomik i importit të pllakave të zdrukthit, fibrës, M.D.F-së në vendin tonë ka anë positive dhe anë negative për vendin tonë. Importi i këtyre pllakave në vendin tonë u bë i mundur në periudhën e tranzicionit dhe vazhdon deri në ditët e sotme për vetë faktin se fabrikat që prodhonin këto materiale u dëmtuan shumë. Për mënjanimin e kësaj dukurie biznesmenët gjetën rrugën e importit për të plotësuar mangësin e materialit drunor për prodhimet me bazë druri të objekteve të ndryshme për plotësimin e nevojave të domosdoshme nga masa e gjerë e popullit. Në vazhdim të viteve janë importuar pllaka zdrukthi, fibre, MDF-je, lëndë e sharruar etj.

Në ditët e sotme importohen rreth 100.000 m<sup>3</sup> pllaka zdrukthi dhe MDF-je, 10.000 m<sup>3</sup> pllaka fibre e parket i melaminuar, etj.

Krahas importit të materialeve të përmendura më lart në vendin tonë u bënë ndryshime në teknologjinë e prodhimeve të objekteve që përdorin si lëndë të parë këto prodhime dhe rezultatet në këtë fushë janë shumë inkurajuese, duke prodhuar objekte me veti cilësore si nga ana funksionale dhe nga vetitë fizike e rezistenca në përdorim. Përveç anëve pozitive importi i këtyre materialeve ndikoi e ndikon dukshëm në kursimin e fondit pyjor. Më poshtë jepen argumentat përkatëse në varësi të importit të pllakave të melaminuara, pllakave të fibrës dhe MDF-së dhe të mundësisë së prodhimit të tyre në vendin tonë. Mbas vitit 2003 deri në ditët e sotme importohen në vendin tonë rreth 100.000 m<sup>3</sup> pllaka zdrukthi e MDF-je, 10.000 m<sup>3</sup> pllaka fibre.

a) Pllakat e zdrukthit me trashësi 18-20 mm dhe MDF-ja me trashësi 18-20 mm kanë zëvendësuar telajot klasike, tamburat, të prodhuara me lëndë druri dhe kompesato, d.m.th. 100.000 m<sup>3</sup> pllaka zdrukthi e MDF-je kanë zëvendësuar 100.000 m<sup>3</sup> telajo e tamburatme një konsum specifik prej 1,5 m<sup>3</sup> lëndë pyjore d.m.th. 100.000 m<sup>3</sup> x 1,5 m<sup>3</sup> = 150.000 m<sup>3</sup> lëndë pyjore, e cila nuk priten në pyll por kursehet.

b) Pllaka e fibrës ka zëvendësuar kompesaton, d.m.th. 10.000 m<sup>3</sup> kompesato janë zëvendësuar me 10.000 m<sup>3</sup> pllaka fibre. Kompesato prodhohet me konsum specifik prej 2,6 m<sup>3</sup> për 1 m<sup>3</sup> kompesato, 10.000 m<sup>3</sup> x 2,6 m<sup>3</sup> = 26.000 m<sup>3</sup> trup për kompesato që nuk priten në pyll nga importimi i pllakës së fibrës prej 10.000 m<sup>3</sup>.

Nga sa më sipër del se nga importi i pllakës së zdrukthit bashkë me pllakën e fibrës e MDF-së, për 1 vit nuk është prerë lëndë druri në pyll në masën 150.000 m<sup>3</sup> + 26.000 m<sup>3</sup> = 176.000 m<sup>3</sup> trupa. Nisur nga fakti që 1 ha pyje ka 160 m<sup>3</sup> lëndë druri, 176.000 m<sup>3</sup> lëndë druri në formë trupash përbëjnë: 176.000 m<sup>3</sup>: 160 ha = 1.100 ha pyje që nuk priten duke kursyer fondin pyjor nga importimi 100.000 m<sup>3</sup> pllaka zdrukthi së bashku me pllaka MDF-je dhe 10.000 m<sup>3</sup> pllaka fibre.

Importimi i pllakave të zdrukthit, fibrës dhe MDF-së përveç fitimit të 1.100 ha pyjesh që nuk priten por nga 1.100 ha pyje kemi dhe një fitim nga rritja vjetore prej 1,7 m<sup>3</sup>/ha lëndë druri. Nga 1.100 ha x 1,7 m<sup>3</sup>/ha = 1.287 m<sup>3</sup> lëndë druri që përfitohen nga rritja vjetore është rezultati i importit të pllakës së zdrukthit, fibrës dhe MDF-së.

## Kushtet cilësore, vetitë fiziko – mekanike e teknologjike të pllakave të importuara

Importimi i pllakave të zdrukthit të melaminuara, fibrës dhe MDF-së për të përbulluar prodhimin e mobiljeve, orendive, dyerve dhe parketit nuk zgjidh problemin në fushën e përdorimit të tyre si lëndë e parë pa plotësuar kushtet cilësore, vetitë fiziko-mekanike e teknologjike të këtyre pllakave. Vlera treguese të vetive fiziko-mekanike të pllakave të importuara, varen shumë nga tre faktorë kryesorë:

a) Nga vetitë e materialit drunor që përdoret si lëndë e parë për prodhimin e tipeve të ndryshme të pllakave të zdrukthit, fibrës e MDF-së.

b) Nga përcaktimi i vetive që duhet të kenë pllakat mbas prodhimit të tyre nëpërmjet përcaktimit të llojit të lëndës së parë, lëndëve ndihmës dhe parametrave teknologjikë, vlerave treguese e këtyre parametrave dhe regjimet në çdo fazë të procesit teknologjik, nëpërmjet të cilëve realizohet transformimi i lëndës së parë dhe ndihmëse në prodhime të gatshme.

c) Nga kërkesat cilësore e vetitë fiziko-mekanike e teknologjike që kërkon prodhimi i mbaruar në formë mobiljeve, orendive, dyerve, parketeve e të tjera. Nisur nga faktorët e përmendur më lart arrijmë në konkluzion se prodhimi i pllakave të zdrukthit, fibrës e MDF-së prodhohen me veti të ndryshme fiziko-mekanike që do të thotë me dendësi të ndryshme, me lagështi përdorimi të ndryshme me thithje uji mbas 2 – 24 orë zhytur në ujë, me rezistencë të ndryshme

në përkulje statike, shtypje etj. ç'ka do të thotë që pllaka e zdrukthit që përdoret për prodhimin e mobiljeve, për dhoma gjumi vlera treguese të thithjes së lagështisë ndikon shumë pak për vetë faktin se në dhomën e gjumit mobiljet nuk kanë kontakt me ujin e kundërta ndodh në prodhimin e mobiljeve të anekseve të guzhinave ku mobilja është pothuajse vazhdimisht në kontakt me ujin. Në këto raste vetia e thithjes së ujit duhet të jetë në minimum pa dëmtuar mobiljen.

Nga vrojtimit e bëra në këtë drejtim vërehet se i gjithë importi i pllakave nuk shoqërohet me fletën treguese të kushteve cilësore e vetitë fiziko-mekanike të pllakave, gjithashtu vërehet se importi i tyre bëhet nga vende të ndryshme të cilët e prodhojnë në vartësi të këkesave që ka prodhimi dhe ekonomia e tyre.

Për të mënjeluar këtë mangësi del e nevojshme dhe e domosdoshme të përcaktohen vetitë e pllakave para fillimit të prodhimit të mobiljeve.

Nga studimi del se suksesi i përdorimit të pllakave të importuara për prodhimin e mobiljeve veç të tjerave varet:

- nga aftësia teorike, shkencore dhe praktike e personelit të prodhimit.
- nga analizat laboratorike që duhet t'i bëhen pllakave të importuara.
- nga zgjedhja e vendit të prodhimit të pllakave të importuara.
- nga përvoja që ka vendi përkatës për përdorimin e tyre.
- nga ngritja e një qendre laboratorike në kuadrin e Departamentit të Drurit në shkallë vendi pranë Institutit të Studimeve e Projektmeve mekanike të drurit.

## Copëza nga jeta e At Gjergj Fishtës

i mblodhi: AHMET OSJA

### Kështu ju mund t'i bëni nder vendit tim

Në vitin 1917, At Gjergj Fishta, me rastin e 5 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, kishte vendosur flamurin kombëtar në mes të kampanjelit të Kishës së Fretënve dhe minares së Xhamisë së Fushëçelës në Shkodër. Komandanti i garnizonit të ushtrisë austriake në Shkodër i kërkon At Fishtës të hiqte flamurin, në të kundërt do ta gjuante me top. Padër Gjergji u përgjigj në çast: - Po e bëtë këtë ju do t'ia rritni mjaft vlerat flamurit të kombit tim, duke e gjuajtur me topat e Perandorisë Austriake!

### Të gjitha lëndët shkëlqyeshëm, vetëm sjellja mjaftueshëm ...

Në vitin e tretë të Seminarit në Bosnje, lëndën e etnografisë e jepnin dy profesorë kroatë, të cilët nuk pranonin autorësinë shqiptare të Eposit të Kreshnikëve. I detyruar të ndiqte orët e tyre, si student i këtij Seminarit, Fishta kundërshtonte me argumente tezat që hidhnin

profesorët. Për këtë "rebelim" ai përjashtohet nga shkolla. Por, rikthehet në shkollë me insistimin e qendrës nga ku Fishta merrte bursën për të ndjekur Seminarin. Në përfundim të shkollës ai do t'i kurorëzonte të gjitha lëndët me vlerësimin shkëlqyeshëm, përveç lëndës së sjelljes, ku do

### Kur shkëputesh nga puna

Të mos të të vijë keq se ke harruar ta kurdisësh orën, por duhet të dish mirëfilli se ajo kur nuk punon, qoftë edhe për një minute, plaket sa për një vit ...

të vlerësohej mjaftueshëm, pasi kishte guxuar të kundërshtonte të pavërtetën.

Ky zell për të mbrojtur shpirtin krijues dhe historinë e popullit të tij, do ta udhëheqë në vitet e mëvonshme teksa merr përsipër të rimodelojë eposin në veprën madhore "Lahuta e Malcisë".

## Edhe kjo është shtëpia e Zotit për shqiptarët

Vitet e para të shek. XX At Gjergj Fishta ishte në Lezhë. Në xhaminë e këtij qyteti shërbente një hoxhë, të cilit i kishte vdekur një i afërm në Shkodër dhe i duhej të shkonte. Po, në të njëjtën kohë, ai qe informuar se disa keqbërës po përpiqeshin të gjenin rastin për të dhunuar xhaminë. Ndaj, në këtë situatë, ai e ndjeu të nevojshme të kërkonte ndihmën e Fishtës. Pasi i tregoi se në ç' gjendje ishte, Fishta e qetësoi, duke e siguruar se asgjë s' do të ndodhte, se ai do të shkonte vetë e do të kalonte natën në xhami, ndaj ai duhej të nisej i qetë për të kryer detyrimin njerëzor dhe shërbimin fetar për të vdekurin.

Në darkë Fishta shkoi vetë në xhami. Nga mesi i natës, te dera u dukën keqbërësit. Fishta u foli atyre në emër. Kjo i trulloi aq shumë ata sa e pyetën: Po ju edhe prift edhe hoxhë?!

- Jo, ua kthej Fishta, - unë jam prift safi, por ju meqë keni ardhë deri këtu hyni e lutuni se edhe kjo është shtëpia e Zotit.

Kështu ai arriti të shuante një sherr, që mund të kushtonte shtrenjtë.

### Kur vlerësohet vazhdimësia

Trashëgimia nuk janë vetëm ata që do vijnë po edhe ata që kanë kaluar.

### Përgjegjësia e vetdijes

Kur njerëzit arrijnë të mësojnë shkaqet, atëherë kanë mundësi të shmangin pasojat.

### Barazpesha

Ekstremet nuk janë të qendrueshme. Varfëria dhe pasuria e skajshme u takojnë ekstremeve.

### Kur je i qendrueshëm

Një vend është në rrugë të mirë kur bijtë e bijat e tij dinë çfarë ka ndodur e çfarë do të ndodhë.

Mittwoch, 20. August 2008

Projektzentrum  
**Albaner schauen sich in Rabutz um**

Rabutz. Das Technisch-Ökologische Projektzentrum Rabutz, das sich dem Thema erneuerbare Energien angenommen hat, entwickelt sich mehr und mehr zu einem Ausflugsziel für internationale Gäste. Erst vor wenigen Wochen besuchten westafrikanische Stipendiaten die Anlage, um sich über die Möglichkeiten der besseren Nutzung der Sonnenenergie im eigenen Land zu informieren (wir berichteten). Dieser Tage nun reisten Interessenten aus Albanien an, um sich das Projektzentrum näher anzuschauen.

Erschienen waren sechs Professoren aus dem Balkan-Land, die gemeinsam mit der Technischen Universität (TU) Dresden und dem Institut für Länderkunde (IFL) in Leipzig ein EU-Projekt zur Entwicklung ländlicher Regionen in Albanien starten wollen. Während drei der angereisten Wissenschaftler in ihrer südosteuropäischen Heimat an staatlichen Universitäten und zwei weitere an anerkannten Forschungsinstituten arbeiten, ist Gazmend Zeneli bereits seit über drei Monaten im Rahmen eines Vorprojekts an der TU Dresden tätig. „Albanien hat in seinen ländlichen Regionen große Probleme mit Bruchflächen sowie mit Erosion“, erläuterte der Gelehrte. Dadurch sei es für die Menschen in diesen Gebieten schwer, Arbeit zu finden.

Durch eine bessere Energienutzung in den strukturschwachen Bereichen soll der Mittelmeer-Anrainerstaat mehr Selbstständigkeit im Bereich Energiegewinn erlangen und letztlich auch zu mehr Jobs kommen. Das EU-Projekt, das sich dieses Vorhaben gesetzt hat, läuft im Rahmen des 7. Forschungsprogramms der Europäischen Union, hieß es. „Im Herbst müssen wir dafür eine umfangreiche Bewerbung in Form eines Antrages auf Fördergelder stellen“, sagte Werner Große von der TU Dresden.

Bei dem Besuch in Rabutz ging es vor allem darum, dass es am Anfang des Projekts wichtig sei, die Menschen in Albanien für die Problematik zu sensibilisieren. „Da müssen wir vor allem auf die Jugendlichen eingehen, denn die sind die Zukunft. Das Projektzentrum von Elk Messerschmidt tut für die Jugendforschung ein hervorragendes Beispiel“, zeigte sich Annette Bergfeld vom IFL von der Exkursion nach Rabutz begeistert.

Auch die albanischen Gäste waren von dem Besuch im Zentrum angetan. „Es ist toll zu sehen, was mit einfachen Mitteln alles zu schaffen ist“, sagte Zeneli. Dennoch würde es sich auch für die albanische Jugend lohnen, mehr Gedankengut ins Erlernen erneuerbarer Energien zu stecken. „Falls wir das Projekt genehmigt bekommen, könnte der Besuch auf jeden Fall der Anfang für eine Zusammenarbeit sein“, waren sich Bergfeld, Große und Zeneli einig.

Julia Wick



Thinaq Lako, Gentil Cupi, Gazmend Zeneli, Arsen Proko und Haki Kola (von links) schauen sich in Rabutz bei Elk Messerschmidt (Dritter von links) um.

**86 YEARS OF ALBANIAN FOREST SERVICE**

January 27, 1923 – 2009



Communal forestry is restitution to the best traditions of forest and pasture governing from the rural communities themselves, in order to control further degradation of the natural resources, to improve degraded forests and pastures, in order to preserve biodiversity and prevent land barring and to improve the living conditions of the land user's families and pastures and forests owners, through the implementation of the principles of the stable and multifunctional breeding of natural resources ...



**Svenskt intresse för kapacitetsuppbyggnad i albanskt skogsbruk**

I september reste en grupp svenska skogsexperter till Albanien för att diskutera ett svensk-albanskt samarbete kring uppbyggnaden av det albanska skogsbruket.

För närvarande stödjer Världsbanken och SIDA projektet NRDP i Albanien (Natural Resource Development Project). Albanien är ett av Europas fattigaste länder. Varje innevånare beskattas ca cirka 15 000-20 000 kronor att leva på. NRDP-projektet stödjer en nation som befinner sig i en övergång till en fungerande demokrati och ekonomiskt samtidigt som befolkningens levnadsvillkor ska förbättras. Den fattigaste befolkningen finns i bergsområden där det också finns skogs- och betesmarker. Idag pågår en omfördelning av ägträttheterna i dessa områden. Tidigare var den mesta marken ägd av staten men nu överförs 65 procent av skogsarealen till kommunerna.

De praktiska insatser som Sverige kan bidra med inom den albanska skogssektorn skulle kunna kopplas till NRDP-projektet eller dess fortsättning. För att kunna bistå kommunerna en gemensam svensk-albansk satsning till sådana insatser krävs förstärkt för de skogliga förhållandena och behoven i Albanien. Därför reste i september den svenska gruppen till Albanien. Gruppen leddes av KSLA-ledamoten Folke Andersson från SLU, och utgjordes i övrigt av Lennart Ackzell från LRF, Eabjörn Andersson från SLU, Bo Thor från Skogsstyrelsen och Bo

Cardestil från KSLA. På programmet stod bland annat möten med den albanska Vetenskapsakademien, det albanska miljöministeriet som ansvarar för skogsfrågor, svenska ambassaden, Världsbanken och den nederländska utvecklingsorganisationen SNV. En dag avsågs till studiebesök i skogsområden i kommunerna Bazi och Ulza norr om huvudstaden Tirana.

Gruppens mål för vistelsen i Albanien var att bekanta sig med skogs- och skogsorganisationerna i Albanien, att sätta sig in de problem som finns inom skogssektorn, att få en överblick över pågående utvecklingsarbete för att kunna harmonisera eventuella kommande insatser med det och att fastställa en lista över relevanta områden för kapacitetsuppbyggnaden i Albanien.

**Förslag till samarbetsområden**

Flera möjliga samarbetsområden kunde identifieras under besöket, områden som föreslås bli föremål för ytterligare diskussioner och koordinering. Det bör att reformera och utveckla Albanien skogsadministration, att utveckla råd-



En del av skog av Malërisht och vidsträckt bakgrunden. Mot dörren. (Foto: Lennart Ackzell)

givningstjänster, att ytterligare utveckla en nyligen bildad skogsgrupporganisation och att organisera fortbildning för att personal inom skogssektorn ska kunna axla de nya yrkesroller som kommer att uppstå inom sektorn.

Efter förslag från albanska institutioner och den svenska gruppens observationer kunde en provisorisk prioriteringslista ligga fram, som fokuserar på behovet av institutionella förbättringar och kompetensutveckling på alla nivåer. Listan pekar också på nödvändigheten av att ta tag i de ekologiska frågor som hör samman med skogsplantering och hållbarhet.

NRDP-projektet har varit mycket framgångsrikt hittills, men ännu återstår ett omfattande arbete. Den svenska delegationen betonar vikten av att ge det stövt den uttrickta tid och den finansiering som krävs för att föra det i hamn. SIDA har nu att ta ställning till huruvida förutseendeinsatserna finns för att stödja ett svenskt deltagande i den fortsatta uppbyggnaden av det albanska skogsbruket.

Text: Folke Andersson/Ylva Nordin



På studieresa i det albanska landskapet. I gruppen ingick, förstom de svenska deltagarna, Dr. Nebat Cullaku, Hr. Haki Kola, representanter från SNV, Ing. Abdullah Diku och två andra representanter från kommunerna Bazi och Ulza.

Foreign press for the development of forest sector in Albania (a German newspaper on the left, and a Swedish above)



**Albanian Association of Forest Specialists, member of the European Union of Foresters**

Prof. Dr. ARSEN PROKO

Page 5



**“Awareness raising on the prevention of fires in forest and pastures”**

- Supported from World Bank -

ECAT Tirana (Environmental Center for Administration and Technology), in collaboration with the Directorate of Forest Service of the districts Vlorë, Sarandë and Delvinë, is implementing the project “Awareness campaign on the situation on fires situation in forests and pastures”, supported from World Bank. This project is complementing project “Inventory of fires in forests and their impact in communal forests in Albania”, supported from SNV (Dutch Organization for Development) ...

Page 3

**KURORA E GJELBËR**

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Tiranë

Këshilli Botues:

N. Çollaku, Th. Lako, M. Kotro, J. Male, F. Memeli, A. Diku.

Kryeredaktor: AHMET OSJA

Zv.kryeredaktor: FERDIN LIÇAJ

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, Z. Ymeraj.

Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë

Mobile: 068 23 23 360; 069 21 11 333; 068 21 42 098

e-mail: velihoxha@yahoo.com

kurora\_gjelber@yahoo.com

www.shkpkk.org



The International Land Coalition is a global alliance of intergovernmental, governmental and civil-society organizations. The Coalition works together with the rural poor to increase their secure access to natural resources, especially land, and to enable them to participate directly in policy and decision-making processes that affect their livelihoods at local, national, regional and international levels.

